Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 183/01
Datë: 11.06.2014

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 11.06.2014 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e Qendrës Rajonale për Aftësim Profesional- Gjakovë, për periudhën 3 vjeçare, 11.06.2014 deri 11.06.2017 për këtë/o kualifikime të aprovuara:

1.1 **Instalues Elektrik; niveli i KKK-së: (III)**

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

1.1.1 Masat e sigurisë duhet të vendosen në secilin panel të punës.

1.1.2 Pajisja me një aparat për matjen e tokëzimit

1.1.3 Të sigurohet që të gjithë kandidatet të hynë në testin hyrës dhe të ruhet dokumentacioni i testit hyrës.

1.1.4 Testi hyrës të plotësohet edhe me pyetje themelore profesionale.

1.1.5 Të përpilohet një plan për trajnime të stafit për zhvillim profesional dhe përditësim të njohurive.

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë:11.06.2014, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

2. Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
3. Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
4. Raporti i Vetë-vlerësimit;
5. Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
6. Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet:

5.1 QRAP- Gjakovë;

5.2 AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi